01-805

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo **Komuna e Prishtinës** Opština Priština – Municipality of Prishtina	PRISHTINA

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 22 & 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr. 05/L-031, dt.21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 dt. 20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës, Nr.110-391 dt. 25.02.2010, UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, 01nr.031-185481 dt.14.08.2015, si dhe duke vendosur sipas kërkesës, 05nr.350/01 - 67407/25 dt.15.05.2025, (KKN-00275) të kërkuesit: Pronarëve Ekrem Hoxha, Enver Hoxha, Adem Hoxha dhe Investitorit "Petrol Kabashi" SH.P.K.me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit ARBK 810816259, rr. Zona Industriale, Magj.Prishtinë-Fushë Kosovë, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin ideor për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesa individuale banimore / shtëpi familjare – **14 shtëpi** të sistemuara në **Tipi**: **"1"** dhe **"2"** me etazhitet P+2, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt për vendosjen e çështjes administrative, me datë 08.12.2025, merr këtë:

V E N D I M
CAKTIMI I KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore kërkuesëve: Pronarëve Ekrem Hoxha, Enver Hoxha, Adem Hoxha dhe Investitorit "Petrol Kabashi" SH.P.K.me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit ARBK 810816259, sipas kërkesës 05nr.350/01 - 67407/25 dt.15.05.2025, *(KKN-00275),* për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesa individuale banimore/shtëpi familjare – **14 shtëpi** të sistemuara në **Tipi**: **"1"**, me P+2 (shtëpi në varg), dhe **Tipi "2"**, me P+2 (shtëpi të veçanta/njëshe), në kuadër të PZHU-së në Prishtinë, konkretisht parcelës kadastrale nr.1313-2, Z.K Prishtinë, sipas projekt propozimit konceptual - Plani i situacionit / "zgjidhja urbane" të prezantuar në këtë drejtori.

II. Lokacioni për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet dhe trajtohet sipas:

- *Planit ZhvillimorUrbanl, miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës, 01 nr.035-181427 dt. 24.09.2013, ku sipas këtij plani kjo zonë është e planifikuar me destinim "Ndërtim individual";*

Pronarët dhe investitori për kriteret dhe parametrat urban, si dhe kushtet e ndërtimit, janë informuar përmes shkresës "Informatë nga Plani Zhvillimor Urban – PZHU" me referencë 04-nr.350/01 – 138983/24 dt.30.10.2024, të lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik të Komunës së Prishtinës.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit / parcelës kadastrale, nr.1313-2 Z.K , sipas gjendjes kadastrale, pronësore, faktike, etj., është:

- Numri, sipërfaqja, pronari & klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, janë:

- nr.1313-2; S=5,231.00m²; Ekrem, Enver dhe Adem Hoxha ;....."Arë e klasit 3";

Sipërfaqja e përgjithshme: S= 5231 m²

- E drejta pronësore - juridike e parcelës kadastrale të lartcekur, është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelës kadastrale të lartcekur nuk ka ndërtesa të ndërtuara, gjegjësisht janë të zbrazëta;
- Terreni kryesisht është i rrafshët;
- Qasja ekzistuese e parcelave të lartcekura, është përmes rrugës ekzistuese,
- Në hapësirën e përfshirë në diametër prej 50 m` ka ndërtesa ekzistuese, shtëpi banimi me etazhitet P+1;

IV. Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" e kompleksit me ndërtesa individuale banimore / shtëpi familjare të konceptuara në dy (2) tipe të shtëpive në kuadër të parcelave ndërtimore të kompleksit:

Tipi "1" – /P+2/ - **9** shtëpi në varg;

Shtëpia **P1**- me sipërfaqe totale ndërtimore S=296.79m²/ *e projektuar dhe të shpërndara nëpër etazhe:*

Përdhesa - S=118.28m²;

Kati 1 - S=118.30m²

Kati 2-S= 60.21 m²

P2- me sipërfaqe totale ndërtimore S=207.20m²/ *e projektuar dhe të shpërndara nëpër etazhe:*

Përdhesa - S=77.70m²;

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

Kati 1 - S=78.70 m²
Kati 2- S= 50.80 m²
P3 - me sipërfaqe totale ndërtimore, S=208.09m²/ *e projektuar dhe të shpërndara nëpër etazhe*;
Përdhesa - S=78.30 m²;
Kati 1-S=78.97 m²
Kati 2 - S=50.82 m²;
P4- me sipërfaqe totale ndërtimore, S=190.41m²/ *e projektuar dhe të shpërndara nëpër etazhe:*
Përdhesa - S=71.43m²;
Kati 1 - S=74.84m²;
Kati 2-S=44.14 m²;
P5 - me sipërfaqe totale ndërtimore, S=178.30m²/ *e projektuar dhe të shpërndara nëpër etazhe:*
Përdhesa - S=66.55m²;
Kati 1 - S=66.95m²;
Kati 2- S=44.80 m²;
P6 - me sipërfaqe totale ndërtimore, S=162.73m²/ *e projektuar dhe të shpërndara nëpër etazhe:*
Përdhesa - S=61.02m²;
Kati 1 - S=61.05m²;
Kati 2- S=40.66 m²
P7 - me sipërfaqe totale ndërtimore, S=160.57m²/ *e projektuar dhe të shpërndara nëpër etazhe:*
Përdhesa - S=60.21m²;
Kati 1 - S=60.21m²;
Kati 2 -S=40.15 m
P8 - me sipërfaqe totale ndërtimore, S=157.52m²/ *e projektuar dhe të shpërndara nëpër etazhe:*
Përdhesa - S=60.20m²;
Kati 1 - S=60.60m²;
Kati 2- S=36.72 m²;
P9- me sipërfaqe totale ndërtimore, S=160.39m²/ *e projektuar dhe të shpërndara nëpër etazhe:*
Përdhesa - S=60.20m²;
Kati 1 - S=60.20m²;
Kati 2- S=39.99 m²;
Tipi "2" - /P+2/ - **5** shtëpi të veçanta/njëshe,
(P10-P14); me sipërfaqe totale ndërtimore, S=284.09m²/ *e projektuar dhe të shpërndara nëpër etazhe:*
Përdhesa - S=112.49m²;
Kati 1 - S=113.50m²;
Kati 2 - S=58.10m²;

V. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor për rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar për ndërtimin e kompleksi me ndërtesa individuale banimore / shtëpi familjare sipas Tipit: "1", "2`", në kuadër të PZHU-së në Prishtinë, përcaktohen bazuar në parametrat, kriteret dhe kushtet urbane, dhe ato janë:

- Organizimi & qasja në kompleks - parcela ndërtimore, pozicionimi, gabariti, etazhiteti i ndërtesave individuale banimore / shtëpive familjare, raporti i ndërtesave me vijat rregulluese & ndërtimore, distanca nga kufiri i parcelave ndërtimore, rrugët dhe vend parkingjet e planifikuara të kompleksit, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit - "zgjidhja urbane" bashkangjitura vendimit kushteve ndërtimore;
- Parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale për organizimin – rregullimin e kompleksit, konkretisht të trajtuara në parcela ndërtimore - sipërfaqe brenda vijës rregulluese, për realizimin e kompleksit me ndërtesa individuale banimore – shtëpi familjare janë:
  nr.1313-2; S=4,254.00m².
- Parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale për organizimin – rregullimin e kompleksit, konkretisht të trajtuara në parcela ndërtimore - sipërfaqe jashtë vijës rregulluese – në rrugë të planifikuar me zgjidhje urbane, për realizimin e kompleksit me ndërtesë individuale banimore – shtëpi familjare janë:
  - nr.1313-2; S=171m²;
  - rrugët brenda lagjes; S=806 m²

  Totali: **S=977 m².**
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës së kompleksit, të jetë për banim individual / shtëpi familjare (*sipas projekt propozimit*);
- Etazhiteti sipas PZHU-së është P+3 etazhe mbi tokë, (*sipas projekt propozimit P+2) bazuar në dritën e diametrit prej 50m'*);

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

Ndërtesa individuale banimore/shtëpi familjare - Tipi: "1", "2",

Tipi "1" – 9 shtëpi në varg: (P1,P9)

P1: S=395 x 0.3=118.50m² / *lejuar sipas Planit/*
S=118.28 m² / *sipas projekt propozimit konceptual /*
P2: S=259 x 0.3=77.70m² / *lejuar sipas Planit/*
S=77.70 m² / *sipas projekt propozimit konceptual /*
P3: S=261 x 0.3=78.30m² / *lejuar sipas Planit/*
S=78.30 m² / *sipas projekt propozimit konceptual /*
P4: S=243 x 0.3=72.90m² / *lejuar sipas Planit/*
S=71.43 m² / *sipas projekt propozimit konceptual /*
P5: S=223 x 0.3=66.90m² / *lejuar sipas Planit/*
S=66.55 m² / *sipas projekt propozimit konceptual /*
P6: S=205 x 0.3=61.50m² / *lejuar sipas Planit/*
S=61.02 m² / *sipas projekt propozimit konceptual /*
P7: S=202 x 0.3=60.60m² / *lejuar sipas Planit/*
S=60.21 m² / *sipas projekt propozimit konceptual /*
P8: S=201 x 0.3=60.30m² / *lejuar sipas Planit/*
S=60.20 m² / *sipas projekt propozimit konceptual /*
P9: S=201 x 0.3=60.30m² / *lejuar sipas Planit/*
S=60.20 m² / *sipas projekt propozimit konceptual /*

Tipi "2" - 5 shtëpi të veçanta: (P10-P14)

P10-P12:S=376 x 0.3=112.80m² / *lejuar sipas Planit/*
S=112.49 m² / *sipas projekt propozimit konceptual /*
P13:S=375 x 0.3=112.80m² / *lejuar sipas Planit/*
S=112.49 m² / *sipas projekt propozimit konceptual /*
P14:S=561 x 0.3=168.30m² / *lejuar sipas Planit/*
S=112.49 m² / *sipas projekt propozimit konceptual /*

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelave kadastrale / parcelës ndërtimore (ISHPN), për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të bodrumit është max.60%, bazuar në paragrafin II. pika 1. të Vendimit 01nr.031 – 185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, dhe sipas llogarive, kjo sipërfaqe është:
  S=560 x 0.6=336.00m² / *lejuar për parcelën maksimale /*
  S=201 x 0.6=120.60m² / *lejuar për parcelën minimale /*
  S=0.00m² / *sipas projekt propozimit konceptual /*
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për hapësira gjelbëruese (ISHPGJ) bazuar në paragrafin II. pika 2. të Vendimit 01nr.031-185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është 0.4 (*40%*), dhe përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, 0.3 (*30 %*), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, dhe sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, kjo sipërfaqe është:

Tipi "1" – 9 shtëpi në varg:(P1-P9);

S=395 x 0.4=158.00m² /*lejuar për parcelën maksimale sipas Vendimit 01nr.031–185481 dt.14.08.2015 /*
S=296.63 m² / *sipas projekt propozimit konceptual /*
S=201 x 0.4=80.40m² / *lejuar për parcelën minimale sipas Vendimit 01nr.031–185481 dt.14.08.2015*
S=86.25 m² / *sipas projekt propozimit konceptual /*

Tipi "2" - 5 shtëpi të veçanta: (P10-P14):

S=560 x 0.4=224.00m² / *e lejuar sipas Vendimit 01nr.031–185481 dt.14.08.2015*
S=385.13m² / *sipas projekt propozimit konceptual /*
S=375 x 0.4=150.00m² / *lejuar për parcelën minimale sipas Vendimit 01nr.031–185481 dt.14.08.2015*
S=224.11 m² / *sipas projekt propozimit konceptual /*

- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas PZHU-së, për banim individual është 0.6-0.8 me etazhitet P+2. Koeficienti ndërtimor i parcelës kadastrale brenda vijës rregulluese – parcelës ndërtimore, do të llogaritet si në vijim: 100% për etazhet mbi kuotën ±0.00, 50% për etazhet me vëllim mbi 51% mbi tokë-suteren, dhe 0% për etazhet e nëntokës-bodrume;

Tipi "1" – /P+2/ - **9** shtëpi në varg;
Shtëpia **P1**- me sipërfaqe totale ndërtimore;
S=395x0.8=316 m ²/ *e lejuar sipas PZHU;*

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

S=296.79m²/ *e projektuar;*
P2- S=259x0.8=207.20 m ²/ *e lejuar sipas PZHU;*
S=207.20m²/ *e projektuar;*
P3 - S=261x0.8=208.80 m ²/ *e lejuar sipas PZHU;*
S=208.09m²/ *e projektuar;*
P4 - S=243x0.8=194.40 m ²/ *e lejuar sipas PZHU;*
S=190.41m²/ *e projektuar;*
P5 - S=223x0.8=178.40 m ²/ *e lejuar sipas PZHU;*
S=178.30m²/ *e projektuar ;*
P6 - S=205x0.8=164.00 m ²/ *e lejuar sipas PZHU;*
S=162.73m²/ *e projektuar;*
P7 - S=202x0.8=161.60 m ²/ *e lejuar sipas PZHU;*
S=160.57m²/ *e projektuar ;*
P8 - S=201x0.8=160.80 m ²/ *e lejuar sipas PZHU;*
S=157.52m²/ *e projektuar;*
P9- S=201x0.8=160.80 m ²/ *e lejuar sipas PZHU;*
S=160.39m²/ *e projektuar;*
Tipi "2" - /P+2/ - **5** shtëpi të veçanta/njëshe,
P10 -12; S=376x0.8=300.80 m ²/ *e lejuar sipas PZHU;*
P13-375x0.8=300.00 m ²/ *e lejuar sipas PZHU;*
P14-561x0.8=448.80 m ²/ *e lejuar sipas PZHU;*
(P10-P14); S=284.09m²/ *e projektuar;*

- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, protokolluar me numrin 01nr.031-185481 dt. 14.08.2016, për shkaqe të kursimit dhe efiçiencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Bazuar në kriteret e PZHU-së distanca dhe *"sipërfaqja e lirë përreth objektit duhet të pozicionohet në kuadër të "ngastrës"- brenda parcelës kadastrale, dhe për të siguruar dritë dhe ajër të mjaftueshëm"*, kjo sipërfaqe e lirë duhet të jetë min.3 – 5m, për të mundësuar ndriçim direkt të mjaftueshëm natyror, nëpërmjet hapjeve në fasadë për hapësirat e banimit (dhoma dite, fjetje, pune, tryezari, korridore, etj.), dhe kjo sipërfaqe e lirë duhet ti referohet kufirit të parcelës, e cila distancë e njëjtë do të vlejë edhe për hapësirën mes dy ndërtesave të kompleksit. Nëse sigurohet pëlqimi i vërtetuar nga pronari/pronarët e parcelave fqinje, kjo distancë mund të zvogëlohet apo mund të ndërtohet në kufi të parcelave, por në atë rast nuk lejohet hapje në ato fasada;
- Ngritja e nivelit të përdheses nga niveli i terrenit lejohet max 0.60m për pjesën e banimit dhe afarizmit;
- Qasja në Kompleksi me ndërtesa individuale banimore/shtëpi familjare të jetë nga rrugët e planifikuara me Plani i situacionit – "zgjidhje urbane" dhe rrugët e brendshme të kompleksit;
- Për çdo shtëpi familjare, të planifikohet një vend parkim, në kuadër të ndërtesës apo kompleksit;
- Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe parkingjet e jashtme, rrugë të brendshme të kompleksit, si dhe shtigjet & trotuaret;
- Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura-dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efiçiencës së energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth;
- Të bëhet aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane dhe arkitektonike të përcaktuar në kriteret dhe parametrat urban të PZHU-së, si dhe me normat dhe standardet tjera të planifikimit.

VI. Ndarja/parcelimi, i parcelës kadastrale nr. 1313-2 ZK Prishtinë, do të realizohet sipas parcelave ndërtimore dhe rrugëve të planifikuara, të përcaktuara me vijën rregulluese, bazuar në Plani i situacionit-"zgjidhja urbane" dhe manualin e ndarjes, punuar nga kompania e licencuar "Geomatika-arch" shpk, me numër të licencës nr. 232. Rrugët e planifikuara brenda kompleksit, sipas Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", pas ndarjes të regjistrohen në regjistrin kadastral me lloj të shfrytëzimit të parcelës "infrastrukturë-rrugë", ndërsa sip. me 171 m^2, jashta vijës rregulluese e cila është e planifikuar për rrugë publike, do të shfrytëzohet si rrugë, mirëpo pas ndarjes të regjistrohet në regjistrin kadastral me lloj të shfrytëzimit të parcelës "pronë private".

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelave kadastrale të lartcekur, sipas Planit të situacionit-"zgjidhja urbane" dhe manualit të ndarjes. Procedura e ndarjes/parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve, duke u bazuar edhe në, Plani i situacionit-"zgjidhja urbane" dhe manualin e ndarjes së parcelave, punuar nga kompania gjeodete e licencuar, e i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VIII. Kyçja në infrastrukturë - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina" aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- *Emri (prindi) Mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;*
- *Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;*
- *Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;*
- *Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;*
- *Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).*

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos" - Ngrohtorja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

IX. Dokumentacioni ndërtimor - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse dhe të licencuar për fazën e projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën V., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", *"Udhëzimi Administrativ MMPH-së 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor"*, bazuar në UA nr.33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- *Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;*
- *Plani i situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:1000;*
- *Plani i situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale - kuota të lartësisë;*
- *Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;*
- *Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;*
- *Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;*
- *Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;*
- *Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5,1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;*
- *Projektin e organizimit të kompleksit , me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;*
- *Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vendndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;*
- *Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;*
- *Elaborati i "Arkitektura e qëndrueshme", i hartuar bazuar në kriteret e përcaktuara në Vendimin e Kryetarit të Komunës, 01nr.031-185481 dt.14.08.2015;*

Dokumentacioni ndërtimor – Elaborati për **Leje Mjedisore Komunale** hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgaditur duhet të përmbaj;

- *Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3) kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;*
- *Certifikatën për regjistrimin e biznesit;*
- *Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;*
- *Kontratën e shfrytëzimit të parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.*

XI. Marrëveshja e infrastrukturës – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 & 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01nr.434/01–94474/17 dt.24.04.2017 dhe Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës"

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

01nr.434/01-227572/23 dt.01.12.2023, obligohet DIKMK e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të ri-mbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin / investitorin.
Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- *Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale / certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);*
- *Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;*
- *Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;*
- *Kontratën për bashkë investim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);*
- *Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);*
- *Kopjen e letërnjoftimit të kërkuesit/ve (bashkëpronarëve të parcelave & investitorit);*

XII. Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore- meqenëse parcela kadastrale nr. 1313-2 ZK Prishtinë në bazë të çertifikatës së njësisë kadastrale, është e evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit "3", kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Planit të situacionit – "zgjidhja urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelave ndërtimore, prej S=4,254.00 m². Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

XIII. Pagesa e taksës administrative për leje ndërtimi dhe tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të kalkulohet/realizohet sipas "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e rregullorës mbi taksën adminstrative për dhënien e lejës së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01nr.434/01-227572/23 dt.01.12.2023, si dhe dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës & tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë;

XIV. Vlefshmëria e vendimit të kushteve ndërtimore është një(1) vit, me mundësi të vazhdimit për një(1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Kërkuesit/ Pronarët Ekrem Hoxha, Enver Hoxha, Adem Hoxha dhe Investitorit "Petrol Kabashi" SH.P.K.me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit ARBK 810816259, me kërkesën 05nr.350/01 - 67407/25 dt.15.05.2025, (KKN-00275), kanë kërkuar nga kjo drejtori caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin ideor për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesa individuale banimore/shtëpi familjare – **14 shtëpi** të sistemuara në **Tipi**: **"1"**, me P+2 (shtëpi në varg), **"2"**, me P+2 (shtëpi veçanta/njëshe) në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

Me kërkesën për kushte ndërtimore kërkesën 05nr.350/01 - 67407/25 dt.15.05.2025, (KKN-00275) është prezantuar dhe trajtuar dokumentacionin dhe provat si në vijim:

- *Dëshmia mbi pronësinë për parcelën kadastrale: Kopja e planit dhe Certifikata e njësisë kadastrale për parcelën: nr.1313-2 ZK Prishtinë;*
- *Projekt propozimi – Projekti konceptual dhe ai ideor i kompleksit dhe tipeve të ndërtesave individuale banimore – shtëpive familjare, hartuar nga "Inzhinjering" n.p.n. nga Prishtina, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810249129, dhe me projektues Msc. Selvije Qorri dhe Hamdi Qorri.*
- *Shkresa "Njoftimi Publik" e datës 03.06.2025 gjerë 16.06.2025, të lëshuar nga kjo drejtori;*
- *Certifikatë e regjistrimit të biznesit npn "Izhinjering", ARBK 810249129;*

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

- *Fotokopja e letërnjoftimit të pronarëve dhe investitorit;*
- *Incizimin gjeodezik të parcelave – "Situacioni i terrenit të parcelave kadastrale me rrethinë", punuar nga kompania e licencuar "Geomatika-arch" shpk, me numër të licencës nr.232;*
- *Manuali i ndarjes, punuar nga kompania e licencuar, me numër të licencës nr.232;*
- *Fotot e njoftimit publik;*
- *Fotot e lokacionit me rrethinë;*

Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit, pas pranimit dhe shqyrtimit të kërkesës për kushte ndërtimore 05nr.350/01 - 67407/25 dt.15.05.2025, *(KKN-00275),* dokumentacionin e prezantuar me kërkesë dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës administrative, konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, si dhe dokumentet e planifikimit hapësinor, aktuale - në fuqi, për atë zonë urbane, në mënyrë kronologjike konstaton se:

Parcela kadastrale, nr. 1313-2 ZK Prishtinë, me sipërfaqe të përgjithshme, përfshihen në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, dhe sipas këtij plani, një pjesë e kësaj zone është e planifikuar me destinim "Ndërtim individual".

Kjo drejtori, pas pranimit dhe shqyrtimit të kërkesës 05nr.350/01 - 67407/25 dt.15.05.2025, *(KKN-00275)*, në emër kërkuesit / pronarëve Ekrem Hoxha, Enver Hoxha, Adem Hoxha dhe Investitorit "Petrol Kabashi" SH.P.K.me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit ARBK 810816259, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor dhe ideor për ndërtimin e lagjes me ndërtesa individuale banimore/shtëpi familjare – **14 shtëpi** të sistemuara në Tipi: "1", dhe "2", me etazhitet P+2, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, konkretisht parcelës kadastrale **nr.1313-2**, ZK Prishtinë, sipas projekt propozimit të prezantuar – Projektit konceptual me "zgjidhja urbane", ka konstatuar se projekt propozimi konceptual në parim është bazuar në kriteret dhe parametrat e dokumentit të planifikimit hapësinor-PZHU-së.

Pas shqyrtimit të kërkesës për kushte ndërtimore, analizimit të Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", dhe duke u bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit të Ndërtimit, Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor, Nr.04/L-174 dt.31.07.2013, dhe nenin 13 të *"Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve"*, me datë 03.06.2025 ka vendosur afishen "Njoftimi publik" e cila ka qëndruar gjerë me datë 16.06.2025, ku sipas rregullativës ligjore të lartekur para caktimit të kushteve ndërtimore, publiku i rrethinës informohet me synimin e kërkuesve dhe ju ofrohet mundësia e dhënies së komenteve duke përfshirë edhe pronarët / poseduesit e parcelave kadastrale të rrethinës në diametrin e dritës prej 50m'. Gjatë kësaj periudhe, gjegjësisht datave të lartë shënuara në postën elektronike të vendosur në afishen e njoftimit publik, nuk ka arritur asnjë koment nga publiku.

Sipas projektit konceptual, shtëpitë familjare janë konceptuar në dy (2) tipe të realizimit, me sipërfaqe dhe etazhitet sipas përshkrimit në paragrafin IV. & V. të vendimit të kushteve ndërtimore, të cilat janë në harmoni me kriteret e PZHU-së dhe Udhëzimit Administrativ MMPH-së 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, si parcelat ndërtimore ashtu edhe sipërfaqet ndërtimore të ndërtesave/shtëpive, duke u bazuar në parcelat minimale dhe maksimale të kompleksit.

Bazuar në pikën 6. të nenit 21 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, ku thuhet që kushtet ndërtimore kërkojnë bazën ligjore të të drejtës për qasje të parcelës kadastrale në rrugë publike, konstatohet se të gjitha parcelat në kuadër të kompleksit, kanë qasje në rrugën e planifikuar me "Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", dhe përmes saj deri te rruga publike. Sipërfaqja e kësaj rruge, e planifikuar dhe e trajtuar me këto kushte ndërtimore, do të mbetet me destinim infrastrukturë rrugore. Njëherë, kompleksi i lartcekur sipas projekt propozimit të prezantuar, është edhe në harmoni me pikat tjera të nenit 21 të ligjit të lartcekur, konkretisht pikës 5 të tij, si dhe shtojcave të përcaktuara me UA Nr.06/2017 të MMPH-së.

Sipas projekt propozimit të prezantuar parcela kadastrale: **nr.1313-2** ZK Prishtinë, janë me sipërfaqe totale prej **S=5,231m²**, ku, nga pjesa e së cilës, janë formuar parcelat ndërtimore me sipërfaqe **S=4,254.00m²,** përkatësisht janë trajtuar në ndërtim, kurse pjesa tjetër, me **S=806.00m²,** është planifikuar për infrastrukturë rrugore të kompleksit (rrugë dhe trotuare etj.) dhe **S=171 m²** sipërfaqe jashta vijës rregulluese.

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, është konstatuar rregullsia e Planit të situacionit – "zgjidhja urbane" dhe kyçja e kompleksit - rrugëve të brendshme të kompleksit me rrugën publike të planifikuar në afërsi dhe ndër të tjera konstatohet:
"Pas shqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Enver, Ekrem dhe Adem Hoxha, në Prishtinë, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05-350/01-67407/25 dt.15.05.2025, kyçja për automjete në rrugën ekzistuese "Gjirokastra" e cila rruge është e paraparë edhe me Planin Zhvillimor Urban, për lagjen sipas zgjidhjes urbane të Enver, Ekrem dhe Adem Hoxha mund të pranohet si e till, marrë parasysh edhe gjendjen

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

faktike të rrugës ekzistuese, ne raport me parcelën 01313-2 Zk. Prishtine. Kyçja e kësaj zgjidhje urbane duhet ti përshtatet teknikisht rrugës së planifikuar, dhe të zbatohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes, dhe në kohën kur rruga realizohet sipas planit, si dhe të zbatohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjeve të çdo ndërtese – shtëpie në rrugën e brendshme te zgjidhjes urbane"

Pas konstatimeve të lartshënuara, dokumentacionit të shqyrtuar, rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht, nenit 18 të Ligjit të Ndërtimit, Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor, Nr.04/L-174 dt.31.07.2013, dhe nenit 13 të *"Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve"*, është prezantuar i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për caktimin e kushteve ndërtimore, dhe projekt propozimi konceptual – Plani i sitiuacionit / "zgjidhja urbane" e propozuar është në harmoni me kriteret e dokumentit të planifikimit hapësinor – PZHU-së, miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës, 01 nr.035-181427 dt. 24.09.2013, në zonë me destinim "Banim individual", andaj vendosi që kërkesa 05nr.350/01-67407/25 dt.15.05.2025 *(KKN-00275)*, kërkuesve: Pronarëve Ekrem Hoxha, Enver Hoxha, Adem Hoxha dhe Investitorit "Petrol Kabashi" SH.P.K.me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit ARBK 810816259, rr. Zona Industriale, Magj.Prishtinë-Fushë Kosovë, të miratohet dhe me vendim të caktohen kushtet ndërtimore, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor dhe ideor për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesa individuale banimore / shtëpi familjare – **14 shtëpi** të sistemuara në **Tipi: "1", me P+2 (shtëpi në varg), "2", me P+2 (shtëpi të veçanta/njëshe)** në kuadër të PZHU në Prishtinë, konkretisht në parcelën kadastrale **nr.1313-2**, **ZK Prishtinë**, sipas projekt propozimit konceptual - Plani i situacionit / "zgjidhja urbane" të prezantuar në këtë drejtori.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i situacionit - "zgjidhja urbane" e Kompleksit me ndërtesa të planifikuara, për parcelën kadastrale nr. 1313-2, ZK Prishtinë, manuali propozimi për ndarje të parcelave si dhe formimi i parcelave te reja katastrale të punuar nga gjeodeti i licencuar.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI, Departamenti Ligjor i MMPHI.

I dërgohet: Kërkuesit/pronarit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës 05 Nr.350/01 - 67407/25 dt.15.05.2025.

I dërgohet përmes postës elektronike: Drejtorisë për Pronën, Drejtorisë për Kadastër, dhe Drejtorisë për Planifikim Strategjik.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05NR.350/02 – 67407/25 DT. 08.12.2025

Zyrtari:
Shkurte Dalipi,

Udhëheqëse e Sektorit:
Nazife Krasniqi,

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGECIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: PRISHTINË

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice :1313-2

Zona kadastrale / Katastarska zona: PRISHTINË

Numri i lëndës / Broj predmeta: 89-2025 DT.10.2025

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcel

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 500

PROPOZIM PER NDAMJEN E PLLACEVE



PROPOZIM PER NDARJEN E PLLACEVE		
NR	Y	X
1	7512090.542	4725311.209
2	7512097.231	4725302.314
3	7512099.491	4725298.885
4	7512103.234	4725293.723
5	7512109.010	4725287.280
6	7512115.400	4725280.160
7	7512119.228	4725275.906
8	7512121.640	4725272.750
9	7512122.190	4725272.025
10	7512130.842	4725260.957
11	7512134.449	4725256.335
12	7512136.759	4725258.523
13	7512135.623	4725259.398
14	7512155.321	4725282.020
15	7512157.200	4725284.339
16	7512168.113	4725297.023
17	7512170.105	4725299.341
18	7512172.970	4725296.740
19	7512182.361	4725307.813
20	7512195.491	4725325.023
21	7512185.822	4725335.172
22	7512173.833	4725347.282
23	7512162.062	4725360.082
24	7512160.663	4725361.581
25	7512139.352	4725345.473
26	7512129.982	4725338.703
27	7512115.623	4725328.484
28	7512124.463	4725281.232
29	7512124.310	4725281.374
30	7512118.247	4725287.029
31	7512121.556	4725290.577
32	7512095.656	4725314.731
33	7512101.981	4725319.088
34	7512102.636	4725319.539
35	7512109.105	4725323.383
36	7512116.295	4725327.653
37	7512123.431	4725331.897
38	7512130.595	4725336.158
39	7512138.417	4725340.761
40	7512144.085	4725344.160
41	7512146.759	4725346.304
42	7512155.111	4725352.997
43	7512156.171	4725352.743
44	7512156.919	4725352.424
45	7512157.646	4725351.968
46	7512158.261	4725351.430
47	7512164.367	4725344.712
48	7512165.289	4725343.539
49	7512165.869	4725342.182
50	7512166.084	4725340.628
51	7512165.903	4725339.199
52	7512165.415	4725337.942
53	7512164.593	4725336.729
54	7512161.085	4725332.962
55	7512154.432	4725325.828
56	7512148.499	4725319.464
57	7512143.039	4725313.615
58	7512137.580	4725307.762
59	7512132.128	4725301.914
60	7512126.672	4725296.063
61	7512129.141	4725286.247
62	7512140.654	4725298.592
63	7512152.584	4725311.383
64	7512163.286	4725322.862
65	7512180.127	4725340.924
66	7512181.072	4725306.293
67	7512156.685	4725283.701
68	7512145.620	4725270.879

Rilevoi / Snimio: ."GEOMATIKA-ARCH"SHPK Lic.01
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 232

Nënshkrimi / Potpis: _____

Data e rilevimit / Datum snimanja: 10.09.2025

Aprovoi / Usvojio: _____
(emri dhe mbiemri i përsonit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

Nënshkrimi / Potpis: _____

V.V.

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____

design	INVESTITORI	"PETROL KABASHI"	
	OBJEKTI	LAGJE BANESORE P+2	
	VENDI I NDËRTIMIT	ARBERI, KOMUNA PRISHTINE	
	PROJEKTUES	Hamdi Qorri, IDA	
		Fatkesa Qorri, IDA	
		Valbona Dobruna MA	
	FAZA	ARKITEKTURA	
	PROJEKTI	SKICË	
		Q.I. SITUACIONI	
		Projektuesi / Data/Viti	01